



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:276054

Datë: 21.07.2023

Numri i dokumentit: 04511086

PS.nr.28/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE–DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË, Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare Violeta Namani-Hajra, në çështjen penale kundër të pandehurve G.M, A.M, D.D dhe H.M, për shkak se cili veç e veç ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, si dhe se cili veç e veç ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri H.M ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.105/22 të datë 22.12.2022, në seancën fillestare të mbajtur me datë 23.06.2023, në praninë e Prokurorit Special, të pandehurve të lartcekur me mbrojtësin e tyre, në bazë të nenit 364 të KPPK-së gjykata me datë të njëjtë publikisht shpalli, dhe me datë **04.07.2023**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

- 1. G.M**, i biri i dhe nënës e gjinisë, i lindur me datë, me vendbanim në fshatin, Komuna, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit nga data deri me datë
- 2. A.M**, i biri i dhe nënës e gjinisë, i lindur me datë, në fshatin, me vendbanim fshati, Komuna, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data deri me datë
- 3. D.D**, i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me datë, me vendbanim në fshatin, Komuna, i pa martuar, ka të kryer fakultetin, menaxher, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data deri me datë
- 4. H.M**, i biri i dhe nënëse gjinisë, i lindur me datë, me vendbanim në fshatin, Komuna, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e Arrestit Shtëpiak nga data deri me datë

I. I pandehuri G.M konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse nga data 02.10.2020 deri me 10.02.2021, në Pejë dhe Prishtinë, i pandehuri G.M i jep ryshfet në mënyrë drejtpërdrejtë të pandehurit B.M, dhe në mënyrë të tërthortë të pandehurit L.S, me qëllim që t'ia mundësojnë përfitimin e subvencioneve në mënyrë të kundërligjshme nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në vlerë 45,210.00€, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri G.M aplikon për subvencion sipas kërkesës nr.21/153671, datë 27.08.2020 me të dhëna të pasakta dhe për të mos u vendosur në listën e zezë, të pandehurit B.M dhe L.S fillimisht i kërkojnë ryshfet në vlerë 10,000€, mirëpo më vonë arrin marrëveshje për vlerën e ryshfetit 8,000€ të jepet në dy pjesë dhe me 03.10.2020 i pandehuri B.M takohet me të pandehurin G.M te pika e derivateve “Kastrati” në Pejë dhe pranon ryshfet në vlerë 4,000€, nga kjo shumë 1,000€ i ndal për vete, ndërsa me 05.10.2020 shumën 3,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, pastaj procedohet Vendimi për pagesë Ref.AZHB....., datë, pastaj sipas marrëveshjes kur procedohet Vendimi i dytë Ref.AZHB....., datë, i pandehuri B.M takohet me të pandehurin G.M në muajin shkurt 2021 afër Stacionit të Autobusëve në Pejë dhe pranon pjesën e dytë të ryshfetit 4,000€, nga kjo shumë për vete i ndal 1,000€, ndërsa pas disa ditësh shumë 3,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në parkingun e ETC-së në hyrje të qytetit të Pejës,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II.

Sepse me datë 27.08.2020 në Pejë, i pandehuri G.M me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pasakta dhe jo të plota në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që, me datë 27.08.2020 në aplikacionin nr..... për përfitimin e subvencioneve ka paraqitur kinse ka të mbjellë sipërfaqe me kultura të ndryshme në sipërfaqe prej 75.95 ha, dhe 92 krerë lopë, ndërsa gjendja faktike në teren sipas super kontrollit të komisionit nga AZHB nr..... datë, ka rezultuar të jetë në sipërfaqe 23 ha dhe 32 krerë lopë më pak se sa ka paraqitur në aplikacion dhe nga kjo gjendje të pasaktë e paraqitur pasi kishte dhënë ryshfet zyrtarëve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ka pranuar Vendimet Ref.AZHB....., i datës dhe Ref.AZHB....., të datës, duke përfituar subvencion në mënyrë të kundërligjshme, duke shkaktuar dëme në vlerë prej 8,400.00€-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 69, 79, 92, 422 par 2, neni 324 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin G.M, për veprën penale Dhënie Ryshfeti, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrest shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.03.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurin G.M, për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 5,000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri G.M, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 92 par 1 të KPRK-së, të pandehurit G.M, në cilësi të sendeve të përfituara me vepër penale i konfiskohen parat në vlerë 8,400.00€, të sekuestrua sipas Urdhëresës PPPS.nr.47/21, të datës 02.02.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. I pandehuri A.M konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse nga data 01.11.2020 deri me 02.02.2021, në Istog dhe Prishtinë, i pandehuri A.M me qëllim të përfitimit të subvencionit në mënyrë të kundërligjshme i jep ryshfet në mënyrë drejtpërdrejtë të pandehurit B.M, në Pejë dhe në mënyrë të tërthortë të pandehurit L.S, të veprojnë në kundërshtim me detyrat zyrtare, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri A.M në emër të biznesit “.....”, kishte aplikuar për subvencione me kërkesë nr..... të datës 26.08.2020 me të dhëna të pasakta, atëherë për mos ta vendosur në listën e zezë arrin marrëveshje për vlerën e ryshfetit 14,000€, pastaj procedohen Vendimet për pagesë ref.AZHB....., dt.19.10.202 në vlerë 35,526.76€, dhe sipas marrëveshjes në fillim të muajit nëntor 2020 i pandehuri B.M takohet me të pandehurin A.M në fshatin në shtëpinë tij dhe pranon ryshfet në vlerë 7,000€, nga kjo shumë 2,000€ i ndal për veti, ndërsa pas disa ditësh shumën prej 5,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, ndërsa nuk jepet pjesa e dytë e ryshfetit në vlerë 7,000€,

sepse pezullohet Vendimi ref.AZHB....., dt.02.02.2021 në vlerë 35,984.26€, për shkak të fillimit të hetimeve,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II.

Sepse me datë 27.08.2020 në Pejë, i pandehuri A.M me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta dhe jo të plota në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që, me të dhënat e birit të tij në emër të biznesit “.....”, kishte aplikuar për subvencione sipas kërkesës nr....., datë 26.08.2020 me të dhëna të pasakta, në bazë të raportit të komisionit të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Istogut nr.09 nr..... i datës 09.12.2020, rezulton se janë përfituar subvencione në emër të duke shfrytëzuar pronën komunale pa autorizim dhe pa leje për shfrytëzim dhe në bazë të verifikimit nga AZHB nr..... rezulton se ka mos përputhje në mes të vendit (parcelave) të digjitalizimit në sistemin sLPIS të pronave me të cilat ka përfituar subvencione me vendin sipas fletave poseduese të dorëzuara dhe në bazë të këtyre të dhënave të pasakta procedohen Vendimet për pagesë ref.AZHB....., datë në shuma prej 35,526.76€, ndërsa për pjesën e dytë pezullohet Vendimi ref.AZHB....., datë 02.02.2021 në vlerë 35,984.26€, për shkak të fillimit të hetimeve, duke shkaktuar dëme në vlerë prej 7.000.00 euro-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 59,61, 69, 79, 422 par 2, neni 324 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin A.M, për veprën penale Dhënie Ryshfeti, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit A.M, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin A.M, për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 5,000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri A.M, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.2, të KRPK-së, të pandehurit i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në mbështetje të nenit 61 par 1 të KRPK-së, obligohet i pandehuri A.M që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës- në vlerë prej **7000 €**.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I pandehuri D.D, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse nga data 02.10.2020 deri me datë 05.02.2021, në Pejë, i pandehuri D.D me qëllim të përfitimit të subvencioneve në mënyrë të kundërligjshme nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë arrin marrëveshje me të pandehurit B.M, në Pejë dhe L.S, për dhënien e ryshfetit në vlerë 5,000€, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri D.D aplikon për subvencione për vitin 2020 me të dhëna të pasakta dhe për mos u vendosur në listën e zezë i kërkojnë fillimisht ryshfet në vlerë 10,000€, mirëpo më vonë arrin marrëveshje për vlerën e ryshfetit 5,000€, pastaj procedojnë Vendimet Ref AZHB....., i datës dhe Ref. AZHB.....i datës në bazë të këtyre Vendimeve përfitohet subvencionin në vlerë 58,600.00€, dhe i pandehuri D.D me datë 18.12.2020 takohet me të pandehurin B.Mn tek “.....” në Pejë dhe i jep ryshfetin në vlerë 2,500€, pastaj i pandehuri B.M shumën prej 2,500€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë, në kafiterit përballë Gjykatës Kushtetuese, ndërsa pjesën e dyte prej 2,500€ nuk mund të jepet të pandehurve për shkak të fillimit të hetimeve,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II.

Sepse me datë 20.08.2020, në Pejë, i pandehuri D.D me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pasakta dhe jo të plota në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që, me datë 20.08.2020 sipas formularit nr..... në emër të biznesit “.....” aplikon për përfitimin e subvencionit për 72000 copë pula dhe paraqet faturat e blerjes nr.1202202004 të datës 12.02.2020, fatura 0303202001 e datës 03.03.2020, fatura 2407202001 e datës 24.07.2020,

mirëpo në bazë të këtij dokumentacioni nuk i plotëson kushtet për subvencionim dhe me kërkesë të pandehurit L.S përmes të pandehurit B.M i kërkohet të pandehurit D.D që të bëjë ndryshime në dokumentacion, pastaj i pandehuri D.D falsifikon faturën 2407202001 e datës 24.07.2020 duke bërë ndryshimin e kësaj fature në numrin e faturës dhe datën e lëshimit me qëllim të paraqiten zogjtë kinse pula vojse për të përfituar subvencion dhe të njëjtën ia dërgon B.Mt, pastaj ky i fundit përmes komunikimit elektronik me datë 28.10.2020 në ora 17:58, ia dërgon faturën e falsifikuar të pandehurit L.S, pastaj procedohet lënda për pagesë të subvencionit sipas Vendimit Ref AZHB.07/4/2-006820/2020, i datës 20.10.2020 dhe Vendimi Ref. AZHB07/4/2-018868/2020 i datës 03.11.2020, duke shkaktuar dëme në vlerë prej 20,000.00€,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 422 par 2, neni 324 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin D.D, për veprën penale Dhënie Ryshfeti, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit D.D, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin D.D, për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 5,000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i pandehuri D.D, nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Avokatura shtetërore për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

IV. I pandehuri H.M, konfom nenit 364 par 1 të KPPRK-së,

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data 01.11.2020 deri me 02.02.2020, në fshatin Loxhë, komuna Pejë dhe në Prishtinë, i pandehuri H.M me qëllim përfitimit të subvencionit nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i jep ryshfet në mënyrë drejtpërdrejtë të pandehurit B.M, Inspektor Regjional në Zyrën Regjionale në Pejë dhe në mënyrë të tërthortë të pandehurit L.S, Drejtor i Pagesave Direkte, në atë mënyrë që, derisa i pandehuri H.M kishte aplikuar për subvencione me 25.08.2020 në kërkesë nr. 21/152506, pas një kohe kontaktohet nga zyrtar e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë se dokumentacioni nuk është në rregull dhe mund të futet në listën e zezë, pastaj i pandehuri H.M duke menduar se mund t'i humb subvencionet, kontakton të pandehurin B.M dhe në bashkëpunim me të pandehurin L.S i kërkojnë ryshfet në vlerë 1,500€, për mos ta vendosur në listën e zezë dhe pas marrëveshjes procedohen për pagesë Vendimet ref.AZHB.07/04/2-018750/2020, datë 02.11.2020 dhe ref. AZHB.07/04/2-0027592021, datë 02.02.2021, në vlerë prej 18,209.00€, pastaj i pandehuri B.M takohet me të pandehurin H.M në shtëpinë e tij në fshatin Loxhë dhe pranon ryshfet në vlerë 1,500€, ku për vete i ndal shumë 500€, kurse shumën 1,000€ ia dorëzon të pandehurit L.S në Prishtinë,-

- me këtë ka kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42,43, 44, 69, 79, 422 par 1, neni të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të KPPRK-së, të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurin H.M, për veprën penale Dhënie Ryshfeti, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit H.M, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Avokatura shtetërore për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.105/22 të dt.22.12.2022, kundër të pandehurve L.S dhe B.M për shkak të veprës penale Marrje Ryshfeti nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, i pandehuri S.SH ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 të KPRK-së, i pandehuri Berat Nika ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 1 të KPRK-së, i pandehuri B.B ka kryer veprën penale Ushtrim i Ndikimit nga neni 424 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit G.M, R.Z, A.M, D.Dj, R.Z, H.M, kanë kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, të pandehurit D.D , H.M, S.B, P.K kanë kryer veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, të pandehurit G.M, R.Z, A.M, D.D, kanë kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 lidhur me par 3 të KPRK-së, të pandehurit R.Z dhe H.M kanë kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.105/22 të dt.22.12.2022, e që aktakuzës ia ka bashkangjitur edhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 16.12.2022, për të pandehurin B.M, dhe marrëveshje me pranimin e fajësisë PPS.nr.105/22 datë 20.12.2022, për të pandehurin B.B.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelor në Prishtinë-Departamentit Special, PS.nr.55/2022, me datë 13.03.2023, pas marrjes së propozimeve dhe mendimit të palëve në procedurë, konform nenit 35 par. 1 dhe par. 2 veçohet procedura penale ndaj të pandehurit B.M, B.B, D.D, S.B, P.K dhe R.Z, për arsyeje të efikasitetit të procedurës të kësaj çështje penale, pasi që në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 13.03.2023, të pandehurit e lartcekur se cili veç e veç e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat janë akuzuar.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 13.03.2023, të pandehurit G.M, A.M, D.D, se cili veç e veç kanë pranuar fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së,,i njëjti pranim është aprovuar nga gjykata, andaj konform 242 par 8 nën par 8.1 të KPPK-së, gjykata ka vendosur që të pezullojë shqiptimi i sanksionit deri në përfundim të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, ndërsa të pandehurit G.M, A.M, D.D se cili veç e veç nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 2 të KPRK-së, si dhe i pandehuri H.M nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së.

Gjykata vlerëson se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka paraqitur pranë kësaj gjykatës parashtesë me datë 15.06.2023, ku ka precizuar vlerën e dëmit për të pandehurit D.D, G.M, A.M dhe H.M, me propozim për mbajtjen e seancës, gjykata ka aprovuar propozimin e prokurori të PSRK dhe ka mbajtur seancën me datë 23.06.2023, ku PSRK ka ndryshuar propozimin në seancë të lartcekur për largimin e të pandehurit H.M, që nuk ka qenë prezent në seancë dhe nuk e ka arsyetuar mos prezencën e tij. Andaj gjykata në kuptim të nenit 241 par.3 të KPPK-së, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, të pandehurit G.M, A.M, D.D, se cili veç e veç ka pranuar fajësinë për veprën penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri H.M ka pranuar fajësinë për veprën penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, pasi që me vetëdije të plotë dhe pa kurrfarë trysnie se cili veç e veç e ka pranuar fajësinë e duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet për pranimin e fajësisë, të cilin pranim e kanë bëri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe kërkoi nga gjykata që i njëjti pranim të aprovet.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelor në Prishtinë-Departamentit Special, PS.nr.55/2022, me

datë 23.06.2023, sipas detyrës zyrtare konform nenit 35 par. 1 dhe par. 2 veçohet procedura penale ndaj të pandehurit G.M, A.M, D.Dj dhe H.M, për arsyeje të efikasitetit të procedurës të kësaj çështje penale.

I pandehuri G.M në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, pas konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin tim, e pranoj fajësinë për veprën penale Mashtrim në Subvencione neni 324 par.1 par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.M Av. Reshat Millaku në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron se pajtohem me pranimin e fajësisë së të mbrojturit tim, të njëjtin e kam njoftuar për benefitet e pranimit të fajit, edhe seancën e kaluar e kemi pranuar të njëjtën sipas këtij paragrafi si ç është sot. I propozoj gjykatës që këtë pranim fajësie ta aprovojë, konsideroj se i mbrojturi im ka pas njohuri se është e ndaluar dhënia e ryshfetit, se përndryshe nuk do të iu jepnin subvencione, i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, bashkëpunimi i tij me prokurorinë, gatishmërinë e tij për kompensimin e dëmit, se sa ka qenë në arrest shtëpiak. Në kuptim të nenit 71 kërkojmë nga gjykata që të bëjë zbutjen e dënimit dhe ti shqiptojë një dënim unik aq sa i akuzuari ka qenë në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, i njëjti është familjarë, ka fëmijë të vogël, është i vetmi mbajtës i familjes dhe fermës, dhe çdo dëmin i lartë do të vë në rrezik ekzistencën e tij.

I pandehuri A.M në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, pas konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin tim, e pranoj fajësinë për veprën penale Mashtrim në Subvencione neni 324 par.1 par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, av.Valon Blakaj në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: pas konsultimit me të mbrojturin tim, i njëjti qysh në fillim e ka pranuar fajësinë, andaj pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse i njëjti pranim fajësie është konform dispozitave ligjore. Kërkoj nga gjykata që ta merr si rrethanë lehtësuese këtë pranim fajësie dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merret parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes, është personi i vetëm që e udhëheq veprimtarinë e njëjtë.

I pandehuri D.D në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: kam kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk kam nevojë për sqarime shtesë, pas konsultimit të mjaftueshëm më mbrojtësin tim, e pranoj fajësinë për veprën penale Mashtrim në Subvencione neni 324 par.1 par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.Dj, av.Salih Mekaj në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: pas konsultimit të mjaftueshëm më të mbrojturin tim, klienti im e pranon fajësinë për veprën penale në trajtën siç është cilësuar në parashtrësën e prokurorisë speciale me datën 15.06.2023. I njëjti e shpreh vullnetin e tij të lirë, pas konsultimeve të mjaftueshme që kemi pas rreth kësaj çështjes, dhe është i bazuar në provat që janë bashkëngjitë në aktakuzë, dhe nga ky aspekt ky pranim fajësisë është bërë në përputhje me ligjin. Gjykatës i propozoj që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, meqenëse konsideroj se i mbrojturi im, ka përgjegjësi të ulët penale, ka qenë në raport me autoritet e shtetit të cilët kanë vendos për dhënien e subvencioneve dhe ky raport duhet kuptuar si i tillë pavarësisht se ata që përfaqësojnë pushtetin janë të akuzuar. Të pandehurit u janë diktuar kushtet për marrjen e subvencioneve, u janë dhënë instruksionet, të cilat ka mujt me i refuzua, por do të humbnin të ardhurat e caktuara, dhe në një mënyrë kjo është një lloj nxitje nga ana e personave zyrtare dhe përfaqëson një rrethanë lehtësuese. Si rrethanë e dytë është roli i të mbrojturit tim, i ulët. Rrethanë tjetër është bashkëpunimi i tij i singertë dhe i plotë me autoritet e hetuesisë prej fillimit të procedurës e deri në këtë seancë. E lus gjykatën që të njëjtën ta aprovojë, sikur të ishte bërë ky pranim fajësie si në ditën e parë të seancës fillestare.

I mbrojturi im ka pas sjellje korrekte, nuk ka ra asnjëherë në konflikt me ligjin, pendimi i tij i sinqerte paraqesin fillimin e procesit për rehabilitimin e tij ende pa ju shqiptuar asnjë sanksion penal. Andaj mendoj se janë plotësuar kushtet ligjore të parashikuara në nenin 71 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 për zbutje të dënimit nën minimumin e parashikuar ligjor. Subvencionet për bujqësi shteti i jep për zhvillim të bujqësisë dhe çfarëdo dënimi me burg do të ishte në kundërshtim me këto qëllime të bujqësisë pasi që i njëjti është pronar i një ferme që ka mbi 50mij zogj dhe pula dhe dënimi me burg do të ishte i dëmshëm dhe një dënim i kushtëzuar do të ishte i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit dhe nuk do ti hiqej e drejta ta ushtrojë veprimtarinë e tij në bujqësi-fermë.

I pandehuri H.M në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim, e pranoj fajësinë për veprën penale Dhënie e Ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, dhe shton se më vjen keq që ka ndodhë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.M, av.Arber Jashari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaron: e përkrahë pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im, konsideroj se është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës duke ia sqaruar benefitet dhe pasojat e pranimin të fajit dhe e njëjta është bërë konform dispozitave të KPP-së. Sa i përket shqiptimit të dënimit e lus gjykatën që përpos pranimin të fajësisë si rrethanë lehtësuese të merr në konsideratë edhe disa rrethana të tjera që ndërlidhen me personalitetin dhe përgjegjësinë e tij penale, se i njëjti është bujk me profesion dhe krejt jetën e tij ka jetuar me djersë dhe të ardhurat i ka siguruar në mënyrë të mundimshme me bujqësi, dhe kurrë nuk ka ra ndesh me ligjin, se deri tek vepra penale ka ardhë për shkak të naivitetit apo manipulimit të personave nën petkun e zyrtarëve shtetëror, dhe se i njëjti nuk ka dashtë të shkaktohet por ata i kanë bërë presion që të japë një shumë të caktuar ndonëse dokumentacionin e ka pas në rregull dhe se i ka plotësuar kushtet sipas ligjit, është familjar mbajtës i familjes, është penduar për gabimin që ka bërë, andaj me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit apo sanksionit penale e lus gjykatën që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit, dhe ndaj tij të shqiptojë një dënim me gjobë. Çfarëdo dënimi tjetër do të ishte fatal për shkak se të njëjtin do ta privonte nga e drejta për të shfrytëzuar subvencionet pa të cilat nuk mund të realizojnë të ardhurat pa subvencione nga shteti.

Prokurori Special i Republikës së Kosovës në seancë fillestare deklaron: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga të gjithë të pandehurit për veprat penale për të cilat ngarkohen, ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimit i propozoj gjykatës që të merret si rrethane lehtësuese pranimi i fajësisë sepse të gjithë të pandehurit janë bujq, dhe që nga fillimi në fazën e procedurës paraprake kanë qenë bashkëpunues me policinë dhe prokurorinë. Andaj me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin i propozoj gjykatës të merr parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprat penale të përshkruara në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga të pandehurit G.M, A.M, D.Dj dhe H.M, ku për shkak të pranimin të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes. Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa-pranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se të pandehurit G.M, A.M, D.Dj dhe H.M e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohen. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në konsultë të plotë me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues e për të cilat të pandehurit G.M, A.M, D.Dj dhe H.M, kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i kanë kundërshtuar, por kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen. Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurve të lartcekur dhe pas dhënies së mendimit të prokurorit special, erdhi në

përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve të lartcekur është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK, dhe të njëjtit edhe e ka aprovuar në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të pandehurit G.M, A.M, D.Dj, tek secila prej tyre formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 2 KPRK-së, dhe me veprimet e të pandehurit G.M, A.M, D.Dj tek secila prej tyre formohen të gjitha elementet e veprës penale Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, te i pandehurit H.M formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënie Ryshfeti nga neni 422 par. 1 KPRK-së, për këtë gjykata të pandehurit e lartcekur i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimet sikurse në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, respektivisht shqiptimit të dënimit me burgim dhe me gjobë, gjykata në harmonim 69, 70 të KPRK, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikimin në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, e ku si rrethana vendimtare të cilat kanë ndikuar në përcaktimi e dënimit janë: pranimi i fajësisë nga të pandehurit G.M, A.M, D.Dj dhe H.M për veprat penale për të cilat akuzohen, pendimi i tyre i thellë për kryerjen e veprës penale, bashkëpunimi dhe sjellja e tyre korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku një fakt të tillë e dëshmon edhe vet përfaqësuesi i organit të akuzës, si dhe është hera e parë që bien ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë pasur të kaluar kriminale apo kanë kryer ndonjë vepër penale, gjithashtu i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshme, nuk do bien ndesh me ligjin dhe nuk do të përsërisin ndonjë vepër penale, çoftë e llojit të kësaj për të cilën janë shpallur fajtorë apo ndonjë vepër tjetër penale, andaj duke u bazuar në të gjitha këto që u elaboruan, gjykata të pandehurve të lartcekur iu shqiptoi sanksionin penal dhe detyrimin sikurse në dispozitiva të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tyre dhe se me këtë sanksion dhe detyrim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, që në të ardhmen të pandehurit e lartcekur të përmbahen nga veprimet e tilla dhe se të integrohen në shoqëri.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuar si në dispozitiva të këtij aktgjykimi janë në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë komfor neneve 449, 450 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.08/L-109).

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.28/2023, datë 04.07. 2023

Zyrtar ligjor,
Rilinda Kadriu

Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

Numri i lëndës: 2022:276054
Datë: 21.07.2023
Numri i dokumentit: 04511086

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.